

VENDIM
Nr.248, datë 27.3.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS SË ZVICRËS, TË PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC) E
DEPARTAMENTIT FEDERAL TË PUNËVE TË JASHTME TË ZVICRËS, DUKE
VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI, PËR
PROGRAMIN “SHËNDET PËR TË GJITHË– HAP”, FAZA E DYTË, PRILL 2019-
MARS 2023, NJË PROJEKT DYPALËSH BASHKËPUNIMI DHE ZHVILLIMI,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.4, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, për programin “Shëndet për të gjithë – HAP”, faza e dytë, prill 2019-mars 2023, një projekt dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi, miratuar me vendimin nr.4, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJA NDRYSHUESE

Në tekstin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, për programin “Shëndet për të Gjithë — HAP”, Faza e Dytë, prill 2019 - mars 2023, një Projekt Dypalësh Bashkëpunimi dhe Zhvillimi”, i miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 6.1.2020, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 4, shkronja “a” riformulohet, si më poshtë:

“a. Deri në datën 31 mars 2023, Qeveria e Konfederatës Zvicerane synon të angazhojë/përdorë fonde në formë granti të parimbursueshëm të barasvlefshëm me një shumë maksimale prej CHF 6'500'000 (gjashtë milion e pesëqind mijë franga zvicerane), e cila do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e projektit sipas qëllimeve të përcaktuara në nenin 3”.

2. Në nenin 11, pas paragrafit të fundit, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

Shtojca 3 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kjo Marrëveshje ndryshuese do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Palët me këtë konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje të bërë në Tiranë
në _____

Në emër të Këshillit të inistrave të Republikës së Shqipërisë

Ogerta Manastirliu

Ministër

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

DHE MBROJTJES SOCIALE

Në emër të Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës

Adrian Maître

Ambasador

AMBASADA E ZVICRËS NË SHQIPËRI

Shtojca 3: Shuma e plotë me 500'000 CHF (franga zvicerane) e pjesës 4 për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019

Shqipëria u godit nga tërmeti në datën 26.11.2019. Si rezultat, u dëmtuan rreth 7000 godina. Ndër këto godina në rajonet e Tiranës, Durrësit, Krujës dhe Laçit, janë dëmtuar rëndë godinat e shëndetësisë dhe në nevojë të menjëhershme rikonstruksioni. Objektet shëndetësore përfshijnë spitalet dhe Qendrat e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP). Për shkak të kësaj ngjarjeje, ekziston një kërkesë më e madhe për punë gjithëpërfshirëse rikonstruksioni.

Puna e rikonstruksionit do të përfshijë një vlerësim të strukturave ekzistuese, rikonstruksionin e godinave të fokusuara në qendrat e KSHP-së dhe mbikëqyrjen e punimit të rikonstruksionit. Një inxhinier i punëve civile do të përfshihet për t'u garantuar që procesi të mos ketë probleme dhe që standardet e ndërtimit të ndiqen siç duhet.

Përpara angazhimit në rikonstruksionin e qendrave të KSHP-së, Ministria e Shëndetësisë ofroi informacion për çdo qendër shëndetësore në lidhje me vlerësimin e kostove dhe shkallën e dëmit nga tërmeti. Paralelisht, ambasada kërkoi Ndihmën Humanitare Zvicerane për të vizituar 5 qendrat shëndetësore (siç propozohet nga MSH) për të kontrolluar gjendjen e tyre nga pikëpamja inxhinierike. Lista e objekteve shëndetësore është si më poshtë:

1. Qendra shëndetësore në Ndroq
2. KSHP në Bubq
3. Qendra shëndetësore në Borizanë
4. KSHP nr. 1 në Durrës
5. KSHP Ishëm, Likmetaj.

Një vlerësim i shpejtë konstatoi gjetjet dhe rekomandimet e qarta për ndërhyrjet në infrastrukturë. Projekti “Shëndetësi për të gjithë” siç parashikohet për fazën e dytë, tashmë ka filluar puna për të përcaktuar më mirë rolin dhe përgjegjësitë që bashkitë kanë në mirëmbajtjen e ambienteve shëndetësore në territorin e tyre. Në fazën e dytë të miratuar do të zbatohet parimi dhe mekanizmi i bashkëfinancimit minimal 30% nga bashkitë në rikonstruksionin e qendrave shëndetësore, me përjashtim të qendrave shëndetësore të dëmtuara rëndë nga tërmeti.

Me përfundimin e punës së rikonstruksionit të qendrave shëndetësore të dëmtuara nga tërmeti, ndërtesat do t'i dorëzohen pronarit përkatës duke qenë Ministria e Shëndetësisë ose institucionit tjetër për të siguruar mirëmbajtjen e ardhshme të objektit.

Numri i synuar i Qendrave Shëndetësore që do të rikonstruktohen në zonat e tërmetit është deri në 5. Bazuar në Projektin Shëndet për të Gjithë, kostoja e investimit të një qendre të vogël shëndetësore është 95'000 CHF (franga zvicerane) me madhësi të moderuar është 250'000 CHF (franga zvicerane) dhe më e madhe është 500'000 CHF (franga zvicerane).

Lista e caktuar e qendrave shëndetësore që do të rikonstruktohen, do të përcaktohet nga Projekti i Ministrisë së Shëndetësisë & Mbrojtjes Sociale (MSH & MS) dhe Projekti “Shëndetësi për të Gjithë”, bazuar në: prioritet, fizibilitet, konfirmim të kostove të llogaritura, niveli social-ekonomik i popullatës i mbuluar nga qendra shëndetësore, përcaktimi i të drejtave të pronësisë ose situatave të tjera ligjore (d.m.th. rastet e përgjegjësisë të firmave të mëparshme të ndërtimit) dhe pas marrjes së moskundërshtimit nga ambasada e Zvicrës.